



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 158, Dhjetor 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



Gëzuar Krishtlindjen! Viti i Ri 2017 me faqe të bardhë!



Arilena Ara, një Zanë e Këngës 12 Magjike

Arilena Ara, vajza e Luigj e Mira Ara, nga lagja Boks, fshati Gjuraj, krahinë e Pultit, por e lindur dhe e rritur ne qytetin e Shkodres, tashme është një këngëtare shumë e njohur. Prinderit e saj, të mrekulueshëm, kanë arritur të daltojnë në formimin e saj dashurin për jetën dhe artin. Kujtojmë këtu përfaqimin, që Arilena i bëri babit të saj, të ndjerit Luigj, në momentin kur ajo u shpall fituese, tek Gjeniu i vogël. Një përfaqimi Falënderimi për babin, i cili sakrifikoi shumë ta sjellte deri tek fitorja. Ai vazhdon të kundroj nga qielli suksesin e vajzës së tij, Arilënës.



KOLONEL PETRIT ÇUNI, NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI

Petritin e njoha në vitin 1998, në detyrën e komandantit të kompanisë së tankeve dhe me gradën kapiten i I-re, në Brigadën e Tankeve, me vendvendosje në rajonin e Melgushës. Një djalë i gjalle, që respektohesh nga të gjithë koleget, eprorët dhe vartësit. E pyeta: Nga jeni i nderuari Kapiten i I-re? Ai, me atë krenarinë prej nga ishte, mu përgjigje: Jam nga Dukagjini, fshati Gimaj, i komunës Shale. Eh, atëherë paskemi se, pse të komunikojmë më shumë e përherë! Dhe unë jam nga Dukagjini, fshati Gjuraj-i them unë. Kështu filloi njohja, filloj shikimi me një sy tjetër në shërbim të funksionit të tij dhe të timin në atë kohe. Dhe vërtete ishte për tu pare ndryshe! Në të gjithë veprimtarinë e tij reflektonte kulture qytetare dhe ushtarake, korrektësi shembullore, përkushtim ndaj detyrës, ...

100 VJET AËRSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

KLERI KATOLIK DHE SHKOLLAT SHOIPE NË DUKAGJIN



Përveç shërbimeve fetare e shpirtërore, kleri katolik, kudo e kurdo, është përpjekur dhe ka bërë punë jashtëzakonisht të madhe për edukimin e besimtarëve, për largimin nga rruga e gabuar dhe lehtësimin e vuajtjeve të kohës.

Një punë shumë e rëndësishme ka qenë edhe hapja e shkollave shqipe sa qe e mundur që herët në histori, por në këto rreshta do të ndalemi në punën që bënë priftërinjtë dhe motrat rregullare të kishës nga Dukagjini dhe për Dukagjinin.

Në vitin 1859, Kushë Micja, që është e para shkollë shqipe për femra, dhe rreth 10 vjet më vonë edhe Tina e Nikës çelë shkollë, po për vajza në Shkodër. Këto shkolla qenë jetëgjata deri në vitet njëzet të shekullit të kaluar.

Pas Shpalljes së Pavarësisë dhe shkëputjes nga pushtimi Osman, dëshira për më mirë, por edhe për arsim dhe kulturë, në veçanti, erdhi gjithnjë në rritje edhe në Dukagjin. Në frontin e parë u vu kisha katolike me priftërit e saj, me qëllim që edhe këtyre malësorëve tu hapet dera e qytetërimit dhe përparimit Europian. Priftërinjtë, që shërbenin si famullitar në këto zona, u treguan të gatshëm që të merrnin përsipër mësimin e nxënësve në gjuhën shqipe, gjë që ishte e jashtëzakonshme për këto zona dhe këta malësorë. Vështirësitë ishin të shumta, për nga ana materiale, por dëshira ishte e madhe nga shumica e malësorëve që fëmijet e tyre të mësonin të shkruanin dhe lexonin gjuhën amtare.

Në vitin 1917, në Theth është famullitar At Shtjefën Gjeçovi. Dhe po këtë vit, në pranverë, At Gjeçovi arrinë të merret vesh edhe me trupat austrohungareze që ishin në Theth dhe në pranverën e vitit 1917 çel shkollën në qelën e kishës, që është edhe shkolla e parë në Dukagjin. Nuk kemi të dhëna për numrin e nxënësve dhe datën, por sipas gojëdhënave nga populli numri i nxënësve ishte rreth 25, djem dhe vajza. Për shkolla të hapura, kudo ku shërbeu At Gjeçovi, pohojnë edhe Prof. Aleks Buda, Prof. Shefik Osmani e studiuesi Sulejman Mato. Për arsye shërbimi fetar, At

Gjeçovi transferohet në Prekal në verën e vitit 1917, dhe atje hap shkollën në shtator të po atë viti, për të cilën ka edhe dokumente.

Edhe shkolla në Plan, sipas kujtimeve të At Justin Rrotës, me 13 qershor të vitit 1919, ditën e Shna Ndout, ka 42 nxënës, të cilët marrin pjesë edhe në meshën e kremtimit të kësaj feste.

Me formimin e Qeverisë të dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua mundësia për të shtrirë këto shkolla më shumë. Në vitin 1921 kemi një numër jo të vogël të hapjes së shkollave në krahinën e Dukagjinit. Kemi mundur të gjejmë disa dokumente që bëjnë fjalë për kërkesa për hapje shkollash, për emrime priftërinjesh si mësues të këtyre shkollave, por edhe informacione që flasin për ecurinë e mësimin dhe nevojat për mjete materiale shkollore.

Dokumente që kemi gjetur rastësisht në arkiva, janë interesante dhe së pari të bëjnë të mendosh se si ka qenë e mundur që të mos përdoren dhe publikohen në asnjë studim publik dhe pedagogjik, aq më tepër pasi këto shkolla janë të pranuar nga shteti i kohës, së dyti, të ndjejë respekt për pasardhësit që jetuan në ato male, se, vërtetë nuk paskan qenë aq të prapambetur e të pashkolluar, pa kulturë, pa lëvizje me drejtim pozitiv sa është paraqitur për dekada nga kalemshinjtë zyrtarë, politikanë dhe qeveritar të kohës, dhe së treti të ndjejë edhe më shumë respekt për punën e kishës dhe famullitarëve të saj në këtë krahinë, për zgjimin dhe ndriçimin e mendjes së malësorëve të kësaj ane drejt përparimit.

Hapja e shkollave në Dukagjin erdhi si bashkëpunim i popullsisë së kësaj zone dhe famullitarëve nga njëra anë dhe shtetit të kohës nga ana tjetër.

Priftërinjtë, duke qenë se ishin gjithnjë të shkolluar, me zemërgjerësinë e tyre morën përsipër organizimin dhe dhënien e mësimin me përkushtim, dhe për këtë komunikimin herë pas herë me nënprefekturën në Dukagjin, drejtorinë e arsimit në Shkodër dhe nëpërmes tyre me Qeverinë në Tiranë.

Duke shfletuar në arkivë për shkollën e Xhanit në Pult, nënprefekti i Dukagjinit Simon Doda njoftonte zyrën e inspektorisë së arsimit në Shkodër më 29.12.1920: "Fillimi i punës ka me kënd prej 1 janarit 1921". Për këtë shkollë Drejtori i Arsimit të Shkodrës njoftonte Ministrinë e Arsimit se "Z. Dom Frano Gjura e muer mbi vedi të dhanunit e mësimin."

Bashkëpunimi midis kishës dhe përfaqësuesve të shtetit në atë kohë, për çeljen e shkollave, duket edhe nëpërmes shkresës të datës 5 janar 1921 që Drejtoria e Arsimit të Shkodrës i dërgonte Ministrisë së Arsimit në të cilën shkruhet: "Po kam nderën mu Ju lajmue se masi u mora vesh më Provincialin e Fretenve P. Pal Dodën, famullitarët e këtyre katuneve mund të marrin mbi vedi të dhanunit e mësimin ...".

Interesant është edhe letra që famullitari

i Thethit At Marjan Prela i dërgonte nën-prefekturës së Dukagjinit me 26.2.1921. Në mes të tjerash në të thuhet: "Populli i Thethit nëpërmjet meje, famullitarit të vet, me këtë shkresë paraqet dëshirin që ka me pa të ngritun sa ma parë prej Drejtorisë së Arsimit, një shkollë fillestare në këtë krahinë." Ai sqaron se fshati kishte 115 shtëpi dhe janë të gatshëm për të ndjekë shkollën, por famullitari sqaron edhe anën politike, "... gjen-dja politike lypë me rritë ma fort njerzënë komtare për shkak që ka për bri Jugosllavin e e bajnë edhe ma të nevojshme ndërtesën (hapjen) e një shkolle." Me 23 mars 1921 Ministria e Arsimit lajmëron Drejtorinë e Arsimit në Shkodër se "... pëlqen hapjen e një shkolle në Theth tue i ngarkue detyrën e mësuesisë z. At Marjan Prelës, famullitar në këtë malësi. Në këtë shkresë, në një shkurtinë të saj shkruhet "Mbi rihapjen e shkollës në Theth" Kjo ndihmon për të vërtetuar atë që kemi thënë edhe më parë se në këtë fshat ka pasur shkollë edhe më parë, dhe për këtë duket se ka njohuri edhe Ministria e Arsimit e asaj kohe, prandaj në shkurtinën e shkresës e quan "rihapje", çeljen e shkollës në Theth.

Në kujtimet e veta At Justin Rota, ish famullitar në Plan shkruan se me 13 qershor të vitit 1919 kishte 42 nxënës në shkollën e hapur pranë qelës së tij.

At Marjan Prela, njoftonte Drejtorinë arsimore në Shkodër për marrjen e emërimit dhe shtonte: "Shkollën e kena çilë me 10 prill 1921. Deri në sot janë shkruar dhe e njëkin me cenë 59 fëmijë." Duke ndjekur kalendarin e lëvizjes së Roza Lane në Dukagjin, autore e librit "Majat e Shalës", gjejmë se me datën 6 prill, kur ajo vizitonte Thethin dhe shoqet e saj, pjesëtare të Kryqit të Kuq Amerikan i dhurojnë kësaj shkolle 3450 korona sermi, e gjetën shkollën të hapur me një numër të konsiderueshëm nxënësish.

Shumë kujdes tregojnë edhe për të njoftuar mbi ecurinë mësimore të nxënësve. Me 7 maj 1921 mësuesi i Xhanit At Frano Gjura i shkruante Drejtorit të Arsimit të Shkodrës: "Nxënës janë gjithsejtë 30 që njëkin shkollën, shpresohet se me vjetin e ri shkolluar numri i tyre ka me u shtue, pse edhe vendi asht tuj e pa nevojën e mësimin". Disa nxënës, shkruan At Frano Gjura, "shkollën e patën njëk edhe përparanej". Kjo të jep për të kuptuar se edhe para njohjes zyrtare nga shteti priftërinjtë që punuan në këto zona u përpoqën për hapjen e shkollave e mësimin e gjuhës shqipe. Më poshtë na mbyllje të këtij informacioni At Frano Gjura shkruante: "...zogjët e malëcisë janë të përgatitur prej natyre dhe me dhunti fort të çmueshme e të radha nga mendja e zemra". Ndërsa drejtori i Arsimit të Shkodrës, pasi e përgëzon për informacionin dhe për zellin që kishte dftue e quan punën e tij "vepër të madhnueshme për qytetërimin e kësaj krahine ...".

Me datën 31 maj 1921 Dom Lazer Borici i kërkonte Drejtorisë së Arsimit të Shkodrës që t'i kërkonte Ministrisë së Arsimit për ta njohur një shkollë në fshatin Sumë. Në fund të kërkesës shpjegonte: "Mësimin e kam fillue tash 2 muej në qelë tëme e janë tue vazhdue 32 fëmi krishtën e mysliman, shpresoj se kanë për tu shtue." Dhe po në këtë datë Drejtoria e Arsimit të Shkodrës i përcillte këtë kërkesë Ministrisë së Arsimit në Tiranë.

Të dhënat e para që na dalin në këto dokumente për shkollën e fshatin Kir të Pultit i

kemi në shkresën e datës 1 tetor 1921 me atë të së cilës At Luigi Bushati emërohet mësues në shkollë të Kirit.

Me 30 shtator 1921 At Marjan Prela lagohet nga Thethi si famullitar dhe si mësues dhe zëvendësohet në të dy detyrat nga At Dedë Berdica.

Pas disa kërkesash te banorëve dhe te famullitarëve për hapjen e dy shkollave, më 17 nëntor 1921 drejtori i Arsimit të Shkodrës sqaronte se njëra shkollë do të hapej në Curraj dhe do të jepte mësim At Nikollë Kaloji që ishte famullitar në këtë fshat, ndërsa për shkollën tjetër përsëri nuk përcaktohet se në cilin fshat të Shalës do të hapej, por në këtë shkresë thuhet se mësues do të jenë At Bon Gjeçaj (në origjinal Gjergji, por sqarohet në shkresa të tjera të mëvonshme se është Gjeçaj) famullitar i ati vendi. Duket se me emërimin Shalë kuptohej Kisha e Shalës që e ka qendrën e Abat. Kjo sqarohet në shkresën e 17 dhjetorit 1921 ku shkruhet nga At Bonaventura Gjeçaj se "... me akt Nr 194 datë 13 k.m. na leqitët urdhnin e të çilunit të shkollës në Shalë dhe emrimin tëm për mësues të kësaj shkolle Shkolla asht çilë në Abat në qelë të Kishës së Shalës." Dhe shtonte: "nëpërmjet mësimin po agon këta popullit drita e gjytetnimit." Në këtë shkollë ishin regjistruar 120 nxënës prej të cilëve 46 vajza.

Provinciali Françeskan At Pal Dodaj me 21 nëntor 1921 përcillte kërkesën e At Zef Mosit për të çelur një shkollë në fshatin Prekal. Ndërsa në shkresën e datës 30 janar 1922 At Pal Dodaj kërkonte shkollë edhe për në fshatin Plan dhe përsëriste kërkesën për në Prekal. Duket se shkolla vijonte për kërkohet që të mbështetej nga shteti. Ai njoftonte se famullitarët e këtyre fshatrave kishin filluar për të dhënë mësim. Në Plan vijonin shkollën 30 fëmijë. Mësuesi i kësaj shkolle që jepte mësim është At Hugolin Gosta kurse për në Prekal nuk jepet të dhëna për numrin e nxënësve, por mësuesi është At Zef Mosi.

Është interesant dhe domethënësi fakti që këto shkolla që u hapën kishin shumë djem dhe vajza që vijonin së bashku, edhe në atë vend që banonin katolikë e musliman shkolla ishte e përbashkët, pa çka se mësuesi ishte famullitari.

Në 100 vjetorin e fillimit të arsimit në Dukagjin kujtojmë më shumë respekt punën e madhe që ka bërë kleri katolik për shtrirjen e arsimit në këto zona. Priftërinjtë që u bënë edhe mësues të gjuhës shqipe të këtyre malësorëve duhet dhe do të kujtohen me shumë respekt për gjithë punën e tyre në ato vitë të vështira.

Vlerat dhe përpjekjet e klerikëve për shkollat në Dukagjin janë të fuqishme, që duhet kujtuar dhe respektuar.

Do të ishte mirë që në Muzeumin Dioçezan në Shkodër të përfshiheshin edhe emrat e priftërinjëve që përhapën dritën e diturinë edhe duke përhapur shkrimin dhe këndimin në gjuhën shqipe.

Kisha është dhe duhet të jenë krenare për punën e madhe që vëllezërit e saj kanë bërë edhe në përhapjen e shkollave shqipe në malësi, por, edhe për besimtarët e saj në Dukagjin.

Luigi SHYTI

Viti 2016 u mbyll me shumë arritje, që janë një bazë e mirë në ecjen e vitit 2017



Viti 2016 po mbyllet, jo me pak realizime, madje në bazë të mundësive tona vullnetare janë realizime që kanë krijuar një bazë të mire, për tu mbështetur në parashikimin e një plani për vitin e ardhshëm mjaft ambicioz.

Gjatë këtij viti janë përgatitë e zhvilluar këto veprimtari:

1-Gazeta "Dukagjini" ka dal rregullisht në çdo muaj, në saj të punës së anëtarëve të redaksisë, me në krye z. Luigj Shyti, e cila ka qenë e palodhur, dhe të mundësorëve të saj, që kryesori është zoti Gjergj Leqejza, i cili ka mbuluar shtatë muaj, botimin e shtatë numrave të gazetës; Vate Musa, i cili ka mbuluar tre muaj, Anton Kosteri dhe Tonin Marku, që kanë mbuluar nga një muaj. Gazeta e muajit dhjetor arrin numrin 158, një arritje mjaft e mirë.

2- Një grup përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", i përberë nga 20 vete, morën pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2016", të cilëve në ditën e pare të tij, miqve ju bë pritja në qytetin e Shkodrës. Në qytetin tonë, jo vetëm u bë vizitë – homazhe te monumenti i Isa Boletinit, të Mehmet Shpendit, të Luigj Gurakuqit e të Shën Tereza, por u pritëm nga Kryetarja e Qarkut, zonja Gerta Bardeli dhe nga N/Kryetari i Bashkisë, zoti Arben Gjuraj, në emër të Kryetares së Bashkisë, zonjës Voltana Ademi. Pastaj u kalua në Mal të Zi, në rajonin e Tuzit, në Istog, në luginën e Rugovës e në Pejë. Ky manifestim u bë me datën 28 deri me 30 prill 2016, me kontributin e secilit pjesëmarrës, por dhe te mjeshtër Mitër Ndreshaj. Nga Kryetari i komunës Istog, zoti Haki Rugova morën një flete nderi, dhe një "Mirënjohje" nga kryesia e shoqatës "Martin Dreshaj"

3- Morën pjesë në shpalljen e Lëvizjes për Shqipëri te Bashkuar, në Prishtinë dhe në Tiranë, me datën 16 e 23 korrik 2016.

4- U zhvillua ceremonia e paraqitjes së studimi "Gjurajt", me datën 20 gusht 2016.

5- U more vendimi dhe u ngrit komisioni për studimin e 100 viteve arsime e kulture në Dukagjin.

6- U zhvillua ceremonia e paraqitjes së monografisë "Nderke Luca" me autor dr. Luigj Martini, me datën 29 tetor 2016,

në bashkëpunim me Teatrin "Migjeni". Në këtë ceremoni u nderuan me titull "Anëtar Nderi i Shoqatës", pas vdekjes, Artisti i Popullit Ndreke Luca e Pjeter Gjoka; Artistja e Popullit, Tinka Kurti; me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", dr. Luigj Martini dhe "Mirënjohja e Shoqatës", piktori Zef Muri. Kjo veprimtari u përgatitë e u zhvillua me kontributin e zotërive Pal Lera, Meritan Spahija e Mark P. Kulla.

7- Morën pjesë në Manifestimin letrar "Ora e Maleve", në Rozhaje, me datën 26. nëntor 2016. Në këtë ceremoni ju dha titull "Mirënjohja Martin Camaj", Manifestimit letrar "Ora e Maleve", dhe titulli "Medaljoni Mehmet Shpendi", Komandantit Adem Nail Kurtaga, pas vdekjes. Pjesëmarrjen tone, në këtë veprimtari e mundësorëve, anëtarit i kryesisë, zoti Mhill Prroni. Përveç titujve nderi, kësaj veprimtarie letrare ju dhuroam libra, si dhe shkollës fillore "Dacaj", në Rozhaje. Në këtë veprimtari, shoqata u nderua me titullin "Mirënjohja", si dhe anëtarët e grupit, Ndue Sanaj, Mhill Prroni, dr. Luigj Martini e Lulash Brigja.

8-Morën pjesë në veprimtarinë e organizuar nga Klubi Letrar "Podguri", në Istog. Në këtë veprimtari ju dha titulli "Mirenjohja Martin Camaj", këtij Klub dhe ju dhuroam gjashtë libra. Pjesëmarrjen tonë në këtë veprimtari e mundësorëve anëtarit i kryesisë, Anton Kosteri e anëtarit i Shoqatës, Lualsh Gjelooshi.

9- I kemi dërguar Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani, dokumentet për herë të dytë, për dekorimin e Zonës së Dukagjinit, të profesor Kole Prella dhe poetin Frederik Rreshpja. Ky propozim është mbështetur edhe nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi, duke i dërguar Presidentit, propozim me shkrim. Në të njëjtën kohë i kemi dërguar edhe programin e veprimtarisë që mund të zhvillohet në Pallatin e Brigadave.

10- I kemi bere një kërkesë Kryeministrit të Shqipërisë, zotit Edi Rama, mbi gjendjen e mjeruar të rrugës së Dukagjinit.

Në këto arritje është kontributi i të gjithë anëtarëve të kryesisë, të anëtarëve të shoqatës dhe i aktivistëve të saj.

Mirënjohje për punën e tyre!

A mundet, të kemi përgatitë e zhvilluar këto veprimtari, të kemi ecur deri këtu, të kemi marre pjesë në gjithë këto veprimtari, pa kontributin e mundësorëve? Patjetër, që jo. Kush janë këta kontribuues:

Gjergj Leqejza 150 000 leke
Vate Musa 62 230 leke
Miter Ndreshaj 55 200 leke
Anton Kosteri 20 730 leke
Tonin Marku 19 000 leke
Pal Lera 10 000 leke
Meritan Spahija 8 300 leke
Mark Pjeter Kulla 1 000 leke
Pjesëmarrësit në manifestim "Zëri Vëllazërisë-2016", me 27 600 leke
Mhill Prroni, Anton Kosteri e Lulash

Gjeloshi jane mundesore ne realizimin e dy pjesëmarrjeve ne Rozhaje dhe Istog.

Këta mundësor i urojmë me gjithë shpirt, me shprehjen popullore, paçin e dhënçin!

A ka pas probleme gjatë këtij viti, që na kanë penguar të ecim më mirë? Patjetër që ka pas probleme:

Së pari, anëtarët e shoqatës nuk kanë paguar kuotat. Gjatë këtij viti kanë paguar kuotat 4 anëtar shoqate, çka përben afërsisht 1.6 % të gjithë arkëtimeve të kuotave.

Së dyti, degët, po të thuash nuk funksionojnë. Nuk mbledhin kuotat, nuk mbledhin lekët e gazetës, nuk përgatisin e zhvillojnë ndonjë veprimtari.

Së treti, edhe anëtarët e kryesisë, që një pjesë janë dhe kryetar seksioni, nuk po paraqesin projekte, nuk po sigurojnë ndonjë mundësor, madje edhe mungojnë jo ne pak raste në mbledhje të kryesisë, madje disa as detyrat që ju caktohen nuk marrin mundimin për ti realizuar.

Shtrohet pyetja e thjeshtë: Kush është Shoqata? A mund të eci shoqata për realizimin e misionit të saj, pa kontributin e të gjithëve, pa mendjen e të gjithëve, pa sakrificën e të gjithëve? Jo.

Të nderuar anëtar e anëtare të kryesisë, anëtare e anëtar të Shoqatës, aktivist e aktiviste të Shoqatës, misioni i shoqatës nuk ka përfunduar, se ai nuk ka fund kurë, çka do të thotë, se Shoqata Atdhetare "Dukagjini", duhet të jetojë, sepse në kushtet e sotme, duhet një shoqate që të kontribuojë për Dukagjinin e dukagjinasi, me kontributin e të gjithëve, me djerësen e të gjithëve, me sakrificën e të gjithëve, se gjithkush i thotë vetës dukagjinasi, ja ka kaq gjë detyrim, Dukagjinin.

Mund të kemi mangësi në komunikimin me njerëzit?! Pa tjetër që kemi. Por të gjithë e dinë, se është një shoqatë, me emrin e madh "Atdhetare Dukagjini", që prej 15 viteve, në mënyrë vullnetare, punon për Dukagjinin e dukagjinasi, pa përfutur askush një kartë telefoni. Pra, intelektualët dukagjinasi, çfarë presin, që nuk bëhen pjesë e saj? Mos valle intelektualët, të shkolluarit dukagjinasi, duhet të kapen për dore e t'iu bëhet lutje që të bëhen pjesë e saj, për të kontribuar, me mendjen e tyre në realizimin e misionit të Shoqatës? Mos vallë biznesmenët duan t'iu lutesh, që të bëhen pjesë e shoqatës e të kontribuojnë në realizimin e veprimtarive të saj, me mundësit mendore e financiare të tyre? Kryesia e shoqatës, mendon se duhet të afroheni edhe ju intelektual e të shkolluar dukagjinasi, ju biznesmen e tregtare dukagjinasi, sepse jo vetem keni mundësi kontribuuese, por Dukagjini e dukagjinasi kanë nevojë për ju, ka nevojë edhe shoqata për ju. Ne, nuk premtojme askujt ndonjë gjë, përveçse i afrojmë NDER, se KRENAR do ta ndjejnë veten brezat e ardhshëm, për kontributin tuaj.

Të bëhemi të gjithë NJË, që të bashkuar do bëjmë më pak gabime, se të bashkuar

ndreqim edhe gabimet, se të bashkuar do të ecim më mirë, do të ecim pa u ndalur në realizimin e emisionit të Shoqatës.

Kam besim, se kjo thirrje, do të jetë pjesë e juaj, do të mendoni se si mund të parashikojmë masat për tu korrigjuar! Kryesia të jetë më aktive, më e përgjegjshme, të bëjë më aktiv anëtarët e Shoqatës dhe të vijomë punën për gjallërimin e Saj, duke prurë të rinj e të reja në shoqatë, duke ardhur në shoqatë intelektualët e të shkolluarit dukagjinasi, biznesmenët e tregtarët dukagjinasi dhe të gjithë së bashku t'ia dalim e ti bëjmë ballë çdo pengesë në interes të Dukagjinit e dukagjinasi.

Pra, duke u mbështetur në arritjet, në punën e mirë që është bërë, në punën e pa kursyer të anëtarëve të kryesisë e të Shoqatës, të aktivistëve të saj, të mundësorëve të saj. për vitin 2017, janë planifikuar këto **veprimtari të shoqatës**:

1-Vijimi i nxjerrjes në çdo muaj i gazetës "Dukagjini", Redaksia e gazetës

2- Përgatitja e veprimtarisë kulturore e artistike, për tu zhvilluar në pallatin e Brigadave, në muajin **mars 2017**, grupi i punës (Aleks Dushi, Roza Pjetri, Dukate Bregu, Marinela Buxha, Luigj Mila, Gjon Dukgilaj, Zef L. Sokoli e Fran Kodra)

3-Marrja pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2017", në muajin **prill 2017**, në Kosovë, Seksioni i veprimtarive dhe të kulturës.

4- Përgatitja e zhvillimi i zgjedhjeve në degë dhe ato të Përgjithshme të Shoqatës, në muajin **shtator – tetor 2017**, Kryesia e shoqatës dhe kryetarët e degëve.

5- Mund të zhvillohen veprimtari përkujtimore e paraqitje të librit, si pas rastit, gjatë vitit, Seksioni i veprimtarive.

Për realizimin e këtij plani duhet dhe një burim financimi, që në saj të bujarisë së tyre, kanë qenë dukagjinasi kudo ndodhur, dhe shpresojmë se, edhe në të ardhmen do të jenë mbështetje e fuqishme financiare në realizimin e misionit të shoqatës.

Projekt buxheti për vitin 2017, duhet të jetë:

1. Për botimin e gazetës "Dukagjini" 228 000 leke
2. Për përgatitjen e zhvillimin e veprimtarisë kulturore e artistike, në Pallatin e Brigadave, 250 000 leke,
3. Pjesëmarrja në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2017", afërsisht 95 000 leke
4. Përgatitja e zhvillimi i zgjedhjeve në bazë dege dhe ato të përgjithshme të Shoqatës, afërsisht 55 000 leke
5. Për veprimtari përkujtimore e paraqitje libri, afërsisht 85 000 leke
6. Urime për festat kryesore 4 x 200 leke 8 000 leke
7. Faqja (faqja) e internetit të

SAMITI I PARË I DIASPORËS SHQIPTARE

Nga data 18 deri më 20 Nëntor 2016, nën patronazhin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama, në bashkëpunim edhe me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të jetës politike, institucionale dhe shoqërore nga Kosova, por edhe nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës, u zhvillua në Tiranë Samiti i Parë i Diasporës Shqiptare, nën moton "TË PANDARË PËR SHQIPËRINË".

Samiti mbledhi për herë të parë, pa dallime politike, gjeografike, prejardhje, gjenerate, rreth 1 000 përfaqësues të shoqatave të ndryshme shqiptare, personalitete të shquar, por edhe anëtarë të thjeshtë, bashkëkombës nga 40 vende, prej të gjithë kontinenteve, me synimin për të krijuar një urë bashkëpunimi, komunikimi e ndërveprimi, në të mirë të ruajtjes dhe forcimit të lidhjeve mes Diasporës dhe Atdheut, si edhe mes komuniteteve të veçantë, në vende e kontinente të ndryshëm.

Samiti vlerësoi lart kontributin e paçmueshëm që Diaspora shqiptare që ka dhënë ndër vite, si për mbrojtjen e të drejtave individuale e shoqërore, ruajtjen e gjuhës dhe identitetit, mbrojtjen dhe avancimin e intereseve mbarëkombëtare, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror në Atdhe.

Në mënyrë të veçantë, Samiti evidentoi rolin kyç që komuniteti shqiptar në Shtetet e Bashkuara, por edhe në Evropë e gjetkë, ka dhënë për çështjen kombëtare në tërësi, si dhe për krijimin e shtetit të Kosovës, në veçanti.

Në pajtim me realitetet e reja në Shqipëri, Kosovë dhe në të gjitha hapësirat e tera ku jetojnë shqiptarë, me dëshirën për të filluar një marrëdhënie të re dhe ndërvepruese, për të ndërtuar një partneritet të qëndrueshëm, përmes zhvillimit të një dialogu të vazhdueshëm e të strukturuar dhe një bashkëpunimi efikas të Atdheut me Diasporën, me bindjen se gjuha, kultura dhe identiteti janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit individual e shoqëror dhe, duke vlerësuar nevojën për të ruajtur, kultivuar dhe zhvilluar trashëgiminë e përbashkët, si mënyra më e mirë për të përfaqësuar dhe mbrojtur të drejtat e komunitetit dhe interesat kombëtarë. Samiti vlerësoi lart iniciativën e qeverisë shqiptare për një përqasje të re në marrëdhëniet me Diasporën dhe konkludoi në nevojën që Qeveria dhe Diaspora, të angazhohen, të bëjnë përpjekje të përbashkëta, në këto drejtime

kryesore:

- I. Zhvillimi Institucional
- II. Diaspora dhe kapitali njerëzor
- III. Diaspora dhe zhvillimi ekonomik
- IV. Mbështetja për diasporën
- V. Mekanizmi ndërveprues.

Ne ketë Samit mori pjesë dhe një delegacion nga Italia që udhëhoqej Dr. Vat Marashi. Tashme i njohur jo vetëm si mjek por dhe si një veprimtar i shquar në diasporë, kryesisht në rajonin e Toskanës ku jeton e punon prej me se 25 vitesh. Ai për shqiptaret dhe veçmas për dukagjinasi, vëllezërit e një gjaku ka dhënë një kontribut shumë të madh.



Një shkrim shkurt ai na dërgon për gazetën "Dukagjini" na njeh me rrjetet në Diasporë si struktura pararendëse që shërbyen dhe morën pjesë në e Samitin e I të Diasporës Shqiptare.

RRJETET E BIZNESEVE TË DIASPORËS SHQIPTARE

Vat Marashi, President i Rrjetit për Italinë Pas Forumit Ekonomik Mbarëkombëtar të shtatorit në NY, një sukses i jashtëzakonshëm ky, me mbi 700 sipërmarrës të ardhur nga 4 kontinente dhe në rreth 25 shtete që kane krijuar e funksionojnë Rrjetet e Bizneseve të Diasporës Shqiptarisë. Rrjeti ynë për Italinë u mbledh dje, date 13. 11. 2016 për një bilanc dhe organizim më të mirë, ndonëse në rreth 9 muaj nga krijimi rezultatet nuk mungojnë.

Ato, mire u pasqyruan dje nga aktiviste të jashtëzakonshëm si:

Berat Ibrahim- përgjegjës për zonën qen-

plotëson detyrimin bazë, atë të dorëzimit të kuotës vjetore, që është e përcaktuar të dorëzohet 1 000 leke, brenda muajit janar të çdo viti.

Ne, në vit duhet të arketojmë 240 000 leke nga kuotat, me të cilat mund të kemi një zyrë pune, mund të botojmë 8 numra të gazetës, mund të botojmë dy libra të shoqatës, që presin mundësinë e tyre. Pra, a e mendoni, se sa e rëndësishme është arkëtimi i kuotave?! Prandaj ka ardhur koha, që disa anëtar të shoqatës, të deklarojnë se 'nuk do të vijoj të jem më anëtar i shoqatës', se sa qenia formale në shoqatë.

Së katërti, gazeta "Dukagjini", del në çdo muaj. Ajo shitet aq pak sa shoqata nuk ka asnjë përfitim financiar prej saj, por kryesia e Shoqatës, redaksia e gazetës dhe në mënyrë të veçantë mundësorët e saj nuk janë kursyer as njëherë për të punuar e për të dal gazetë në kohë, dhe me përbajtje gjithnjë rritje. Dhe, jo ve-

drore të Italisë, sipërmarrës i suksesshëm e patjetër njeri i pastër e patriot i flakte;

Dr. ssa Marsela Koci, përveç se gazetare në "Web Internatinal Post", me një pendë të mprehte dhe inteligjente, është pjesë e grupit të veriut dhe jo vetëm sensibilizon sipërmarrës të rinj ti bashkohen Rrjetit tone, por ajo është edhe një ndërmjetësuese e shkathet dhe e denje me institucionet përkatëse. Si mund t' mos përmend, pasardhësin dinjitoz të Legjendës mbarëkombëtare, të Gjergj Kastriotit, gazetarin dhe zëdhënësin e Bashkisë në Foxhja të Italisë,

Dr. Loris Castriota Skanderbegh, një intelektual se i thjeshtë aq edhe i thelle, i cili ka krijuar tashme një sistem lidhesh me interes për Rrjetin tone në Itali dhe së shpejti do çojnë sipërmarrësit e pare për investim diku në trojet amtare;

Dott. ssa Arjana Bechere, tashme njihet për shpirtin "luftarak" në organizimin,

edhe disa projekte me valence humanitare të konsiderueshme.

Pa mundur t'i përmend të gjithë, me gjithë ndonjë defekt të vogël, Rrjeti hodhi një hap shumë të rëndësishëm në planin organizativ dhe në ata perspektiv.

Kush është dr. Vat Marashi?

- Ka lindur 12. 07. 1960, në Gimaj, në krahinën e Shalës, zone e Dukagjinit,
- Ka kryer shkollën e mesme, në vitin 1978, në Breg-Lumi, Dukagjin,
- Ka kryer Fakultetin e Mjekësisë në vitin 1985, në Tiranë, diplomuar Mjek i Përgjithshëm

- Në vitin 1985 – 1990, mjek në spitalin e Iballës-Puke, edhe si Drejtor, 24/24 ore

- Në vitin 1990, specializohet për Pediatricin e Gjinekologjinë.

- Në vitin 1994 – 1996, në Firence Itali, specializim për Sëmundjet e paralindjes

- Në vitin 1998, Diplomohet në Universitetin e Firences - Fakulteti i Mjekësisë, dhe për më se 18 vjet punon si mjek në sektorin shtetëror të mjekësisë.

- Në vitin 2004 mbaron specializimin në degën e Mjekësisë natyrale: Homeopatia, degë që e ushtron prej 12 vjetësh.

- Në vitin 2009 mbaron një specializim tjetër të Mjekësisë Natyrale: Antropozofia

- Në dy të fundit (2014) ushtron profesionin si Mjek privat në Firence Itali.

Punët dhe funksionet kryesore si veprimtar shoqëror me emigrantet shqiptar:

- Në Korrik i 1996, ku krijon shoqatën "Albania" in Toskana,

- Në vitin 2001 me shoqatën "Kordinimit te Shqiptareve në Toskanë", që ndihmon emigrantet shqiptare dhe me gjere me të gjitha shërbimet e nevojshme, falas si mjek dhe përfaqësues në emigracion, ka shpërndarë shumë ndihma materiale për emigrantet shqiptar në nevojë.

- Për një periudhe rreth dy vjeçare - President i të huajve, në Provincën e Firences - deri në shkrirjen me dekret të provincave.

- Nga 1998 - me dekret të Qeverisë italiane - Natare i Këshillit Territorial të Emigracionit.

- Nga shkurti 2016 - Kryetari i Rrjeti të Bizneseve të Diasporës shqiptare për Italinë.

Gjon Fierza

Shoqatës 6 000 leke

Shuma e përgjithshme 672 000 lekë.

Disa detyra:

Së pari, anëtarët e kryesisë, pavarësisht punëve që kanë, problemeve të përditshme familjare, duhet të gjejnë mundësinë për ti kushtuar edhe shoqatës disa orë në javë, se vetëm kështu shoqata do të eci më mirë dhe do të jetë më e suksesshme në realizimin e misionit të saj.

Së dyti, kryetarët e degëve duhet të jenë më të përgjegjshëm, më aktiv për detyrën fisnike që kanë marrë përsipër. Nuk është e lehtë të jesh kryetar i degës, sepse ajo kërkon më shumë përkushtim e sakrificë në plotësimin e detyrës.

Së treti, anëtarët e shoqatës duhet të jenë më të përgjegjshëm e më aktiv në plotësimin e kërkesave të statutit. Nuk mund të jesh anëtar i shoqatës, kur nuk

+

Gjithsesi, është bërë punë e mirë, sepse ka pasur përkushtim, çka nuk duhet të mungojë as në të ardhmen. Mbi bazen e kësaj pune e të këtij përkushtimi është miratuar Planin e Veprimtarive të Shoqatës, për vitin 2017 dhe mundësohet realizimi i veprimtarive.

Megjithatë, nuk përjashtohen sugjerime për të bërë përmirësime në ecjen e përgatitjes e zhvillimit të tyre. Prandaj ju bëjmë thirrje intelektualëve e të shkoluarve dukagjinasi, biznesmenëve e tregtarëve dukagjinasi, të japin kontributin e tyre.

Gëzuar e për shumë mot, festën e Krishtlindjes! Gëzuar e me faqe të bardhë viti i Ri, 2017!

Ndue SANAJ, Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

KOLONEL PETRIT ÇUNI, NDERI I SHOQATËS ATDHETARE DUKAGJINI

Petritin e njoha në vitin 1998, në detyrën e komandantit të kompanisë së tankeve dhe me gradën kapiten i I-re, në Brigadën e Tankeve, me vendvendosje në rajonin e Melgushës. Një djalë i gjalle, që respektohesh nga të gjithë koleget, eporët dhe vartësit. E pyeta: Nga jeni i nderuari Kapiten i I-re? Ai, me atë krenarinë prej nga ishte, mu përgjigje: Jam nga Dukagjini, fshati Gimaj, i komunës Shale. Eh, atëherë paskemi se, pse të komunikojmë më shumë e përherë! Dhe unë jam nga Dukagjini, fshati Gjuraj-i them unë. Kështu filloi njohja, filloj shikimi me një sy tjetër në shërbim të funksionit të tij dhe të timin në atë kohe. Dhe vërtete ishte për tu pare ndryshe! Në të gjithë veprimtarinë e tij reflektonte kulture qytetare dhe ushtarake, korrektësi shembullore, përkushtim ndaj detyrës, kërkues dhe respekt ndaj vartësve, hapësira ku shtrihet kompania e tij ishte shembull për të gjithë të tjerët, guximtar dhe punëtorë i palodhur.

Bëra përpjekje të ndjek gjithë ecurinë e tij të mëtejshme, kur isha në detyrë dhe pasi dola në pension, që shpesh jemi takuar e kemi shkëmbyer mendime për reformimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë se, ai ishte dhe është një oficer karriere i kompletuar.

Kur u informova, që N/kolonel Petrit Çuni është emëruar Komandanti i Universitetit Ushtarak "Skënderbe", ose siç i themi ndryshe: Akademisë "Skënderbej", ndjeva kënaqësi të jashtëzakonshme, jo vetëm që e meriton këtë funksion mjaft të rëndësishëm, por dhe sepse më në fund, një djalë nga Dukagjini, me punën e tij arrin në këtë detyrë mjaft të lartë dhe të rëndësishme. Pastaj, Pedagog Përgjegjës i Kursit Lartë të Oficerit, Akademia e Forcave të Armatosura Tiranë. Në muajin gusht 2013, emërohet Shef i Degës së Menaxhimit e Mbeshtetjes së Bazës & Përfaqësues Ushtarak i RSH në NATO, në Komanden e Forces Bashkuar të NATOS Brunssum Hollandë. Tani, me 16 korrik 2016, është emëruar në detyrën Drejtor i NATO-s, BE dhe Marrëdhënies me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes.

Me urdher të Ministres së Mbrojtjes, me nr. 1786, datë 08 shtator 2016, gradohet me gradën e lartë, Kolonel.

Çfarë do të them më gjatë, me duket jo e drejtë se, për Kolonel Petrit Çuni më shumë se kushdo tjetër flete CV-ja e tij, të cilën e botojmë më poshtë.

Kolonel Petriti, e gëzosh gradën, në emërin tim e të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", të uroj me shprehjen dukagjinase: **Me faqe të bardhë gradën dhe detyrën e re!**

GENERALTETET

Emri: Petrit
Atësia: Pal

Mbiemri: Çuni
Datëlindja: 6 Shtator 1969
Vendlindja: Shkodër
Vendbanimi: Tiranë
Gjendja Familjare: i martuar, tre fëmijë

ARSIMI

1984 - 1988, Shkolla e Mesme e Përg-



jithshme Ushtarake "Skenderbej" Tiranë;
1988 - 1992, Akademia e Forcave Tokësore "Skenderbej" Tirane specialiteti Tanke/Teknik;

Maj 96 - Shkurt 97, Ndjekur Kursin e Gjuhës Gjermane pranë ATF Tiranë;

Prill - Shtator 1997, Praktikën e trupave dhe Kursin e Komandantit të Batalionit (Shkolla e Tankeve në Munster Gjermani);

Tetor - Dhjetor 2000, KTHOSH Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit në Akademinë e Mbrojtjes Tiranë;

Prill - Qershor 2004, Kursin intensiv të gjuhës Angleze Nivelin i parë në Brigadën e Reagimit Shpejtë Tiranë;

Shtator - Dhjetor 2005, Kurs intensiv për gjuhën Angleze në Q.Gj.Huaja Brigaden e Reagimit Shpejtë Tiranë;

Janar - Qershor 2007, Kursin e Gjuhës Angleze në Shkollën e Gjuhës Angleze CFLS (Canadian Force Language School)

Nivel i Dytë Base Borden ONTARIO, KANADA;

Nëntor 2007 - Qershor 2009, Studime në Akademinë e Drejtimit Gjermani (Kursin e Gjeneraleve / Admiraleve me pjesëmarrje Internacionale/ Bundeswehr Leadership Academy in Hamburg;

Qershor - Korrik 2009, Kursin për Sigurinë Europiane (Eurokurs) në Akademinë e Drejtimit Gjermani;

Shtator - Dhjetor 2010, Studime "Programi për studime të avancuara të sigurisë lartë", në Qendrën George C.Marshall Gjermani'

Prill - Korrik 2011, Kursi gjuhës Angleze Nivelin 3/2/3/2 në QGJH AM "SPIRO MOISIU" Tiranë;

Shtator 2011, Seminar: "Aspektet ligjore të Krimit Kibernetik dhe të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar"

Zyra e ODC Tiranë;

Tetor 2015, Kursin orientues për stafin e NATOs (NATO Staff Orientation Course) në shkollën e NATOs Oberammergau Gjermani;

KARRIERA/EKSPERIENCA NE PUNË

15 Korrik 1992, Titulluar Oficer ;

Gusht 1992 - Nëntor 1993; Zv. Komandant Kompanie në Batalionin e Tankeve në D17K B. Curri

Nëntor 1993 - Tetor 1995, Komandant i Batalionit të Tankeve në RU

Komandant i Kontigjentit Paqeruajtës Shqiptare në Bosnie & Hercegovin (BiH)

Nëntor 2007 - Korrik 2009, Me Studime në Akademinë e Drejtimit Gjermani/ Bundeswehr Leadership Academy in Hamburg;

Shtator 2009 - Prill 2010, Zv/Komandant i Universitetit Ushtarak "SKËNDERBEJ" Tiranë;

Maj 2010 - Tetor 2011, Zv/Komandant, Ai dhe për arsimimin AU "SKËNDERBEJ" Tiranë;

Nëntor 2011 - Shtator 2012, Komandant i Akademisë Ushtarake "SKËNDERBEJ" Tiranë;

Tetor 2012 - Korrik 2013, Pedagog Përgjegjës i Kursit Lartë të Oficerit, Akademia e Forcave të Armatosura Tiranë;

Gusht 2013 - 15 Korrik 2016, Shef i Degës së Menaxhimit e Mbeshtetjes së Bazës & Përfaqësues Ushtarak i RSH në NATO Komanden e Forces Bashkuar të NATOS Brunssum Hollandë;

15 Korrik 2016 e në vazhdim, Drejtor i NATO-s, BE dhe Marrëdhënies me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes.

Një karriere ushtarake, e shkëlqyer! (N. S.)

GRADIME

Në vitin 1992 Gradën Nëntoger

Në vitin 1994 Gradën Togër

Në vitin 1995 Gradën Kapiten i Parë

Në vitin 2004 Gradën Major

Në vitin 2009 Gradën Nënkolonel

Shtator 2016 Gradën Kolonel

Për punën e bëre ka marre dhe vlerësime gjatë gjithë kësaj karriere të shkëlqyer:

"Medalja e Karrierës" mbi 10 vjet shërbimi në F. A, akorduar nga Komandanti i Forcës Tokësore, me 26. 11. 2004;

Medaljen e Misionit në Operacionin ALTHEA 2005 në BiH;

Çmimin e Komandantit të akorduar nga Komandanti i Trupave Gjermane në Operacionin ALTHEA BiH, Prill 2005;

Medaljen e Misionit në Operacionin ALTHEA 2006 në BiH;

Çmimin e Komandantit, akorduar nga Komandanti i Trupave Gjermane në Operacionin ALTHEA BiH, Maj 2006;

"Medalja e Karrierës" mbi 15 vjet shërbimi në F.A akorduar nga Komandanti i Forcës Bashkuar, me 21. 11. 2007;

Medaljen "Për pjesëmarrje në shërbime Ndërkombëtare", akorduar nga Ministri i Mbrojtjes, me 30. 11. 2007

"Medalja e Karrierës" mbi 20 vjet shërbimi në F. A, akorduar nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, me 26. 11. 2012;

GIUHË TË HUAJA të mbrojtura me Dëshmi: anglisht, gjermanisht.

Kolonel Petriti Çuni, krenaria është fjalë e vogël për të përshkruar çfarë ndjej në përfundimin e këtij shkrimi modest, për karrierën tënde të shkëlqyer! Jo vetëm ishim të bindur kur kryesia e Shoqatës të dha titullin e lartë "Nderi i Shoqatës Atdhetare-Dukagjini", por ajo bindje përforcohet gjithnjë e më shumë, dhe me gjithë forcën e shpirtit, të urojmë jetë të gjatë dhe me faqe të bardhë!

Ndue Sanaj,
Kolonel në pension

Dy takime dhe shumë kujtime

- Reportazh nga veprimtaritë letrare në Rozhaje të Mali i Zi dhe Istog të Kosovës -

Me 26 Nëntor 2016, në Rozhajë

PAK HISTORI

Tregovishta (Rozhaja e sotme), vendbanim i krijuar rrëzë një kështjellë të dikurshme, i përmendur nga udhëpërshkruesi i njohur turk Evlija Qelebiu dhe gjeografi turk Mustafa haxhi Kalfa. Këtë emër Rozhaja e sotme

ta (Rozhaja) si vendbanim është krijuar nga fisi Kuq (katër lagje të familjeve Fetahajt, Beqiragajt, Ganiqët, Kardoviqët, Colakovici i Hadzici) dhe Kelmendët (dy lagje, Zenelagajt dhe Kurtagajt). Objektet e vjetra kulturore në Rozhajë dallohen; vendbanimi ilir në kodrën e Brezës (Brezojeviqëve), xhamia e Kurtagajve dhe kulla e Ganiqëve. Koumna Rozhaje ka një

lanica, Kallaçaj, Kolena | Llomnica e Epërme, Llomnica e Poshtme, Pauçina, Pllunçaj, Radetina, Seoshnica, Sinanoviçi dhe Vuçi. Komuna Rozhaje ka rreth 22 693 banore, me përbërje: Boshnjak 19 269 banore, shqiptar 1 158 banore, e të tjerë ... Nëse gërmojmë në historinë e shkruar dhe atë gojore, Rozhaja ishte ndryshe nga sot, në të cilën ka pak emërtime në gjuhën shqipe dhe shqip flitet pak ose me frike.

Një grup i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ishim të ftuar në Manifestimin letrar, e pagëzuar me emrin "Ora Maleve", në Rozhajë, në Republikën e Malit i Zi. Një veprimtari e përvitshëm mbarëkombëtare kulturor dhe letrar, që mbahet në respekt të rënëve në lufte për çlirim të Kosovës.

Të ftuar nga ideatori dhe drejtuesi e kësaj veprimtarie, z Ali Daci, ndiheshim të obliguar, por edhe të respektuar.

Një bashkësi krejt e vogël shqiptar në këtë qytet, rreth 1158 banore, megjithatë kjo veprimtari e përvitshme, ka fituar emër dhe ka bere jehone.

Pjesëmarrjen në këtë veprimtari letrare e mundësoj z Mhill Prroni, dhe së bashku me kryetarin z. Sanaj e shkrimtarin z Luigj Martini, pas një rrugë të gjatë dhe të lodhshme mbërritëm në atë qytet të vogël. Në asnjë ditë të vitit ky qytet nuk ndihet më shqiptare, kane ardhur nga të gjitha anët, poet, studiues, gazetarë, veprimtarë të çështjes Shqiptare.

Një ditë për shqiptarët, kështu mund të cilësohet kjo ditë festive e mbushur me një kalendar veprimtarish: një ekspozitë me piktura e hapur që në mëngjes, në sallën për kulture të këshillit komunal. Mjaft vizitor, mjaft foto e kujtime, por edhe mirënjohje e vlerësime. Pastaj veprimtaria vijoi në sallën e madhe, që u zhvillua pjesa tjetër e programit.

Një dokumentar mbi disa nga filmat e kineastit shqiptar, Isa Qosja. Mjaft mbresëlënëse dhe interesant, por edhe artistik e prekës. I vlerësuar me disa çmime ndërkombëtare për punën e tij, Profesor Isa Qosja mori duartrokitje dhe vlerësime nga të pranishmit.

Me korrektësinë, autoritetin dhe elementet që përcjell Shoqata Dukagjini kudo që shkon imponon vlerësim dhe merr përgjime nga organizatorët. Pas fjalës përshëndeste kryetari Ndue Sanaj, dorëzoi disa vlerësime dhëne nga kryesia e Shoqatës. Manifestimi Letrar "Ora e Maleve", u nderua me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", me motivacion: "Për punën e vlefshme në lëvrinën e poezisë shqipe, e cila është një urë lidhëse e fuqishme e hapësirave shqiptare"; Komandanti Adem Nail Kurtaga, pas vdekjes, u nderua me titullin "Medalioni Mehmet Shpendi", me motivacion: "Në detyrën e komandantit të forcave vullnetar për mbrojtjen e trojeve shqiptare tregoi aftë-

si të larta organizative e drejtuese, i vendosur deri në flijim për mbrojtjen e tyre, luftëtar i paepur në lufte për çështjen nacionale", te cilin e mori pasardhësi i tij, Dr. Kenan Kurtaga. Gjithashtu, Drejtuesit te këtij manifestimi dhe shkollës fillore "Dacaj" ju dhuruan disa libra.

Tek pjesa letrare, në hapësirën e poezive, poetet pjesëmarrës lexuan nga një poezi. Edhe Lulash Brigja lexoi një poezi, me titullin "Unë jam dukagjinasi".

Nuk dua të përcjell vlerësimet, por dua të përshkruaj emocionet e mija. Ishte vërtet bukur, kur tek çdo fjalë që flitej shqip të dukej se mikpritësve ju shkëlqenin sytë. Kur je në veprimtari, kur je në mes miqve orët dhe dita kalon si pa kuptuar.

Pasditë programi na çojë tek salla komode e hotel restorant "Albi", në të cilin kaluam disa ore vërtet të bukura.

Nga organizatorët ishte parashikuar ndarja e mirënjohjeve për pjesëmarrësit, përshëndetje dhe leximi i shumë poezive. Me titullin "Mirënjohja" e kësaj veprimtarie u nderua Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe pjesëmarrësit, Ndue Sanaj, Mhill Prroni, dr. Luigj Martini dhe Lulash Brigja. Biseda vëllazërore, diskutime mes kolegësh, foto dhe trokitje gotash. Këto ishin refreni i asaj pasdite mjaft të bukur.


Fotot flasin sa fjalët, ato do ti ruajnë përjetësisht kujtimet e kësaj dite Shqiptare në Rozhajen tone. Në u larguam në mbrëmje duke lënë prapa një atmosferë festive që ka vazhduar deri vonë, duke marre me vete mirënjohje, respekt, kuraja dhe dëshirën për të qenë atje përsëri.

Me 3 dhjetor, në Istog

PAK HISTORI

Kjo hapësirë ku sot gjendet Burimi sipas arkeologëve ka qenë e banuar që nga kohërat e lashta. Kështu në rrethinën është gjetur një varreze punuar nga zëjtaret Dardanë, koha e punimit nuk dihet mirëpo dihet që vjegëza 15 centimetra e gjatë, paraqet një hark (simbol i dhëmbit të syrit) dhe feçkë të dërrit të egër. Ky punim është bërë nga bronzi dhe është i fshehur diku nga serbët apo kisha serbe.

Komuna e Istogut, ka një sipërfaqe rreth 454 km2 dhe një popullsi rreth 39 727 banore. Qyteti është Burimi dhe fshatrat janë: Baja, Banjica (Banjëza), Belica, Bellopoja, Cerrca, Cërkolezi, Carralluka (Fushëmira), Dobrusha (Drenusha), Dragoleci, Dreja, Dubova e Vogël (Driloni i vogël), Dubrava (Drejana), Gurrakoci, Gusari, Istogu, Istogu i Poshtem, Kalliqani, Kamenica (Temali), Kashica (Drinas), Kërnina, Koshi, Kovraga (Krasniqaj), Lubova (Thana), Lubozhda (Nëngurra), Luga (Verrishta), Llukafci I Begut (Begaj), Llukafci i Thatë, Mojtstiri, Muzhevina (Muzakaj), Orrobërda (Arbana), Osojani, Padalishta (Pemishtja), Polana (Fushëpali), Prekalla, Prigoda, Rakoshi, Saradrani (Dasam), Sudenica (Gurrasi), Suhogërl-



e mbanë deri në Tregovishta (Rozhaja) të cilin emër Rozhaja e sotme e mbanë deri në vitin 1912 kur okupohet nga Mali i Zi. Në fillim u quajt Rozanj, Rrozaj dhe së fundmi Rozhajë, serb. Rožaje. Tregovish-

sipërfaqe 452 km2; perbehet nga qyteti, Rozhaja dhe 25 fshatra: Ballotiqi, Boxhovi, Baqi, Bashqa, Besnik, Bellacërka, Bisheva, Bogaj, Bukovica, Černokërpi, Dacaj, Grahova, Grizhica, Ibërci, Jabl-





la (Syrigana), Shalinoci (Shala), Shushica (Gashaj), Syneja, Tomoci, Trubuhovci (Osmanaj Niti), Tuqepi, Uça, Veriqi (Vërrini), Vrella (Tedeli), Zabllaci (Frashni), Zallci, Zhakova (Dardha)

Kur bashkëpunimet dhe kontaktet janë mbresëlënëse edhe vështirësitë e pengesat për të qenë prezent kapërcehen. Kështu ndodhi edhe me ne, në rastin e ftesës për të marre pjesë, të ftuar në konkursin mbarëkombëtar poetik për çmimin "Ibrahim Rugova", në Istog, me 3 dhjetor 2016. Në kuadër të

manifestimit. "Zëri i Vëllazërisë" kemi shkuar disa herë në Istog, por këtë rralle ishim të ftuar nga Klubi letrar "Podguri", në edicionin e dytë të këtij konkursi.

Mirënjohje për kryetarin e klubit letrar "Podguri", Sadik Bicaj dhe sekretarin e tij, Nuredin Imeraj. Shoqata Atdhetare "Dukagjini", atje gëzon një respekt të veçantë! Së pari, për prezantimin me nivel te larte. Kjo u pa edhe në kontaktet me drejtuesit lokal dhe në veçanti me kryetari e komunës, z. Haki Rugov. Në Kosovë kam vënë re se pushtetarët janë më miqësorë dhe

më serioz me njerëzit e penës. Para se të fillonte pjesa letrare, përshëndeten drejtuesit e Klubit letrar "Podguri" dhe ata të Komunës. Në pjesën poetike, u paraqiten poetet nga të gjitha hapësirat Shqiptare. Nuk kishte emra të mëdhenj të poezisë, ndoshta edhe për arsyen e organizimit online të fazave të mëparshme, por përkushtimi dhe korrektësia ishin maksimale. Ne u përfaqësuam aty fale mbështetjes të kryetarit të degës të Shoqatës për Shkodër, z. Anton Kosteri dhe anëtarit të Shoqatës, z. Lulash Gjeloši. Në emër të Shoqatës tone, përshëndeti Kryet-

ari Sanaj dhe me vendim të kryesisë së Shoqatës, u dorëzua titulli "Mirënjohja Martin Camaj", Klubit letrar "Podguri", me motivacion: "Në respekt të punës suaj për promovimin e kulturës tonë kombëtare. Si mirënjohje për bashkëpunimin midis artisteve dhe poetëve të këtij klubi letrar me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", i cili ju dorëzua kryetarit te Klubit, z. Sadik Bicaj. Gjithashtu këtij klubi, i dhuroj disa nga librat e tij në publicistike. U shpërndanë çmimet përkatëse dhe mirënjohje për poetët. Poetja Hasije Selishta Kryeziu fituese e çmimit të parë mbarëkombëtar "Dr. Ibrahim Rugova".

Pjesa më argëtuese dhe më miqësore ishte dreka e shtruar nga organizatorët. Na pritë dhe na shoqëroj kudo rapsodi i njohur Ismet Demaj, një mik i vërtet i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", por së pari, një njeri me shpirt artisti. Këngë, valle dhe muzike deri vonë.

Me poetet te ftuar, miq e mike të kësaj veprimtarie letrare, qe ne mes tyre ishte dhe poetja shkodrane, Farida Ramadani, poetja nga Tirana, Luljeta Pashollari dhe poeti e studiuesi Nikoll Loka, qëndruam së bashku, biseda, përvoja, por edhe bisedua për projekte të reja. Këto ishin temat e orëve të vona në mes poetësh, në Istog.

Të nesërmen miku ynë Antoni, na mundësoj të vizitojmë Rahovecin e vreshtave pafund, por edhe Prizrenin e lavdishëm..

Ne e shijuar më se miri këtë udhëtim pune, u përpoqëm të prezantojmë sa më mire veten, Shoqatën, por edhe Shkodrën, që kosovarët e adhurojnë shume.

Unë jam i kursyer me fjalët kur flas dhe kur shkruaj, le të mbeten në gazetë këta pak rreshta dhe foto. Në memorien e secilit nga ne do mbetet një kujtim i bukur dhe me vlera ky udhëtim në Kosove. Ndoshta këtu lindi ideja apo dëshira, që të them se edhe ne mundemi të bëjmë diçka të ngjashme.

Ngaqë është fund - viti më lejoni të uroj, Gëzuar lexuesve të gazetës tone dhe dukagjinase Festen e madhe, Krishtlindjen!

Gëzuar vitin e Ri 2016 e me faqe të bardhe! Gëzuar Shqiptarëve kudo që jetojnë!

Përgatiti, Lulash Brigja



Kryetari Haki Rugova, duke i dorëzuar poetës Hasije Selishta Kryeziu, çmimin e Pare mbarëkombëtar "Dr. Ibrahim Rugova"



PJETER DEDA, FIGURË E LANUN NË HARRESË

Nuk e di sepse, por isha tuj i hjedhë një sy vizatimeve të mija të hershme, që i kam në një dosje të veçantë, kur më doli para portreti i Pjeter Dedës, skenografit të parë të teatrit profesionist. Data 2 gusht 1956. Ishte në moshën 35 vjeç. Ishte shkollue në shkollën Françeskane dhe, me që ishte nip i At Benardin Palajt, ishte punesue po aty. Unë isha, ende, pa i krye studimet e Pikturës dhe veç punës në "Repartin e pikturës", që bashkë me Bahri Jubanin e patëm krijuar në janar 1953, ndiqsha kursin e pikturës, në shtëpinë e kulturës, që drejtohej nga piktori i njohur Vladimir Jani. Repartin e kishim në një dyqan, përball "Marubit".

Ishte kohe tepër e vështirë për Pjeter Dedën. I hjedhur si zehle, në rrugë të madhe, poshtërsisht (e them këtë, pa e teprue), prej teatrit, me fëmijë të vegjël, ai vuante për bukën e gojës dhe kërkuj nuk i binte nder mend për t'i gjete, së paku, një pune të thjeshtë, sa për te mbajte frymën.

Në mënyrën ma të ultë, në librin e L.Fishtës, për problemet e historikun e skenografisë, thohet se u hoq për paaftësi.

E pra, ai ishte, me të vërtetë, talent. Këtë e kane dishmë, sa e sa skena të dra-



mave e komedive, të punueme me fantazi e mjeshtri prej tij, nder të cilat mund të kujtojmë "Gjin Bue Shpata", "Oso Kuken", e të tjera, me ndihmën e tij të madhe.

Vinte e rrinte në repartin e pikturës se, si ç' thonte, nuk kam ku shkoj e s' kam ç' ka baj.

Ishte njeri i urtë, tejmase, i qetë, që s' dinte kurrë të nervozohet, njeri që mbante, me një durim të stërmadh, çka i sillte jeta; njeri që nuk mbante huj as inad, edhe pse ia kishin ba me të padrejte. Njeri që, vetëm heshte.

Na ndihmonte shpesh, kur kishim periudha ngarkese, sidomos në raste festash dhe, kur merreshim shpërblimet e i jepeshim hisen e asaj që kishte punue, ai kundërshtonte dhe asnjëherë nuk i mori, tue thane: S'po kam çka baj e u mora me diçka, e jo për shpërblim.

Ndershmënia e tij, ishte e dukshme në çdo hap e besidë të tij. Nuk e ndiem, kurrë, te mburrej për punën e vet, e cila çmohej e lavdërohej prej tjerëve.

Në atë kohe, banonte në rrugën e "Tre Heronjve", kah fundi – majtas, në një shtëpi përdhese, ku varfëria e tejskajshme sundonte në te. Pa shtretën, por me një turrë të vogël shiltesh, ma fort se dyshekë, por që mobilja ma e kushtueshme ishte kavalleti, me një pakice bojërash e një talajo mbi te, si dhe dosja e vizatimeve, që merrte me vehte, kur shkante në turne dhe mblidhte aty do nga natyra dhe elemente, për skenat e ardhshme, me tema kombëtare.

Nuk kishte krye shkollë artistike por, fale talentit e vullnetit, ai arrijti profesionalizmin, tue na dhanë vepra të mirëfillta të nivelit të nalte artistik, që fatkeqësisht (vizatimet e maketet të punueme e të detajueme), janë asgjësue, që në fillim, kur ai u hodh në rrugë të madhe, e madje, tue hjedhë edhe balte mbi te e tue ia mohue edhe talentin e autorësinë e disa skenave si p. sh "Koprraci", "Toka e jone", "Agimi" e të tjera (në salonin e vjetër). Më vret tepër ndërgjegjja, që këtë shkrim, fort të vogël, por çka meriton ai, e baj kaq vonë, por me duket se lehtësova shpirtin tem, për këtë Njeri të Madh, shembull talenti e përvujtnije e, do të ftojsh edhe të tjerë, që e kane njoftë apo ndigjue për te e mund të dinjë, të shkruajnë dy fjalë, se për Pjeter Dedën s' asht aspak e tepërt, ashtu si do të ishte e mire të thuhej diçka, edhe për Gjon Hillen e të tjerë figura të harrueme, të skenografisë.

Pjeter Deda e mbylli jetën para kohe, në vorfni e prej skamje, natyrshme, sëmundja ia preu "pejzat e jetës", një talenti në kulmin e forcës të tija krijuese.

Vdekja ma e tmerrshme asht lanja në harresë!

Pjerin Sheldija

PROFESORI PREKE VUKSANI, NË ALTARIN E DIJES



Dhjetëra breza të rinjsh Dukagjinas do të përkujtojnë për jetë e mot mësuesin e dashur, profesorin që edukoj të duan dijen, njeri-tjetrin dhe vendlindjen.

Jo larg por diku në një xhep të Alpeve Shqiptare për afro 40 vite ka kontribuar në arsimin Dukagjinas si arsimtar në Toplanë, Brashtë e për rreth 28 vite Drejtor i shkollës së sistemit 8 e 9 vjeçar, si dhe Drejtor i shkollës së mesme në Komunën Shosh.

Prek Vuksani, ka lindur në fshatin Ndrejaj, qendra e ish-kooperativës, më pas Komunë, pinjoll i një familje të shkëlqyer nder breza, i biri i Nikë Vuksanit, njëri nga kolosët mendimtarë Dukagjinas i cili rresh-tohej në krah të Bal Markut, Gjon Marashit e të tjerë, vëllai i pestë nga vëllezërit, pas Gjeloshit, Lushit, Palit e Vates.

Unë kam pasur fatin ta njoh që në moshën 13 vjeçare nga afër Prof. Preken, pasi kemi lidhje miqësie, së pari ai ishte mësues i brezit tim, ishte i dashur me një komunikim të hollë aristokracie dhe së dyti një mik i rrallë në rrafshin njerëzor. Ai që përcolli shumë breza nuk mund të quhet thjesht arsimtar, edukator por tashmë ngjitet në Altarin e Dijes, ku me të drejtë brezat i thërrasin Profesor, pasi nga shkolla

e tij kemi me qindra intelektualë mjaftë të zotët të shpërndarë kudo në Shqipëri e jashtë saj, Ai drejtuesi më jetëgjatë në arsimin e Shoshit.

Ai mbizotëroi në mbjelljen e kultivimin e dashurisë së njeriut për njeriun, duke konsideruar prindin e nxënësit si koleg në mbarëvajtjen e punës, duke e konsideruar nxënësin e mirë si koleg të së ardhmes e nxënësin e dobët si partner të domosdoshëm në rrugën e jetës. Por përveçse Ai ishte i matematikës, (të cilët brezi im i njej si cinik), ishte njohës i shkëlqyer i historisë, i dashuruar me letërsinë e artin, të cilin e bën të afrueshëm e të dashur si për bashkëfshatarin por i gjendur këmbëkryq me elitën jo vetëm Dukagjinase por më gjerë. Përkushtimi për familjen e të vetët, është hapje sipari për brezat, duke qëndruar shumë lart me karizmin e tij ndërmjet brezash, për të ndikuar fort mes të vjetrës me modernen, me qellim final ushqyerjen e familjes së shenjtë si domosdoshmëri për shëndoshjen e shoqërisë sonë. Dukagjinasi



me mendimtarët e gojëtarët e tyre kanë pasuruar visaret e kombit me epikën legjendare, ndërsa mua më lind e drejta sot në kohë moderne të imagjinoj : se bash në Ndrejaj, të Shoshit nga mesnata nisnin vallëzimin e tyre zanat (orët e malit) për të shtegtuar në luginën e Shalës, për të pushuar në Theth për në Bjeshkët e Namuna. Porse para dy muajsh në fund të shtatorit pas një ataku kardiak në mesnatë të Profesor Prekes, Zanat duket se e ndërprejnë vallen, duke nisur gjamën e duke njoftuar se tashmë jeta e pasosur e prehja në paqe është vendosur përfundimisht nga Zoti. I dashur Profesor Preka! Tashmë Zoti vendosi të ndajë parakohe nga ne, miqtë, kolegët e familjarët, por se do jesh pranë nesh i kujtuar për dashurinë njerëzore e intelektuale që afrove, sikurse do të përpiqemi të shërbejmë mirë këtej, me qëllim se kur të vijmë tek JU, të prehem edhe ne në PAQE. Ti do mbetesh përjetësisht krenaria e miqësisë time dhe e secilit që të njohu nga afër. Jam i sigurt se preheni në PARAJSE.

Zoti qoftë me familjarët e TU!

Përgatiti Agron Perbibaj

Veprimtari nderi, në 145-vjetorin e lindjes së At' Gjergj Fishtës,

Tetori, i përcjellur në media si muaj i leximit të librit, përjetoj mes nesh edhe dimensionin tradicional, të përmasës letrare, si muaj i letërsisë, falë përkujtimit dhe nderimit, njëherish, edhe të pënavës të mëdha, të nderuara dhe vlerësuar kombëtarisht për ato përmasa rritjeje dhe dinjiteti estetik që vepra e tyre i dha dimensionit të identitetit tonë kulturor kombëtar. Si i dashuruar

ftuar në veprimtarinë përkujtimore që Këshilli i Qarkut, organizoi për birin e saj, të madh, në 145-vjetorin e lindjes së Tij, më 21.10.2016, sipas një platforme shumë të goditur: Takimi poetik kombëtar, ora e muzës "Lissua-2016" dhe shpallja e fituesve të çmimit letrar, rajonal, "Gjergj Fishta", edicioni i pestë, nën moderimin brilant të poetit të talentuar lezhjan, Viktor Gjokolaj. Nëse për

konkursit letrar, dr. Sadik Bejko, shkrimtari Andrea Petrimilo, botuesi Rexhep Shahu, gazetari i TVSH-ës, poeti Demir Gjergji, kritiku letrar Kadri Ujkaj, poeti Vilson Cula, poeti kosovar Adem Zapllusha. Në atë mjedis sa festiv, sa letrar aksesi fishtjan, në diasporën tonë në SHBA-ën, do të lexohej aq bukur dhe funksionalisht në praninë e publicistit dhe intelektualit z. djalit lezhjan, z. Zef Përgega, i nderuar si



poezi nga Ndue Mici

TË LARGUARËVE

Ika.
Po iki.
Këtu s'ke ç'ka ban!
Këtu të gjithë rrinë
Askush nuk punon!

Të gjithë duan të ikin.
Gjithkush don të largohet.
Se gjithkush thotë,
Kështu nuk jetohej!

Po, a duhet të ikim?
Të ikim të ta'ne?!
Po vendin tonë,
Kujt duhet t'ja lamë?!

Ky vend i bukur
Ku lindë e rritë jemi
Asht Atdheu ynë
Trashëgim e kemi.

Të parët amanet na e kanë lanë
Ndaj duhet të tanë
Të punojmë me mish e me shpirtë
Që vendin tonë ta bëjmë dritë!

Gjithë botën ta shetisë anembanë
Nuk gjen kërkund si vendin tand
Kthetuni pra në vendin tuej
Se këtu keni lindur, e s'jeni të huej!



poezi nga Pjeter Martin Cani

PRELE MARKU

Në luge të Ndermajës,
në kufi me Shalë
Mbjell djelmnia anë e mbanë
Nëpër Nikaj e nëpër Shalë
Ai Prele Marku ja la vetit
Rreh tallaz si valët e detit
Në krue të gurit ujë kapi
Tring Shytania i pat dhanë gji
Në mort e dasma ish në shërbim
Diskutim s'pan duart e ti
Sikur shënjt ish për kufi
Ky nip Lotajsh, nuk njohti frikën
Rreze lëshoi e çau errësirën
Me kullë të Frangut matet ky burrë
Pat respekt Nikaj – Mertur
Jua la Prela firmën e vulën
Tash tre breza se lan rrugën
Dhe Dede Kolen e pat kushëri
Brezat mbajnë emrin e ti
Lavdi, për jetë lavdi.



"Dersá t'mundem
me ligjrue
E sá gjáll
me frymë un jam,
Kurr Shqypni,
s'kam me t'harrue,
Edhe n'vorr
me t'permendë kam."
At' Gjergj Fishta

pas librit, ndryshe pas ndjesive estetike të fjalës, si njohës dhe studiues i letrave shqipe, u ndjeva në këtë atmosferë tetori disesi i privilegjuar brenda vetes nga përkatësia ime, direkte apo indirekte si "shkodran". Aspak rastësisht, por në substancën e vet estetiko-filozofike, Shkodra, ky djep veterani i kulturës dhe i civilizimit tonë kombëtar, sado paradoksalisht që të sillet me vetveten deri edhe kur nuk të gëzon "së jashtëmi", ka magjinë, falë potencialit të saj estetik, të të provokojë "së brendshmi" drejt një diversiteti – shtysë, të llojit të vet, për të qenë gjithnjë e më kritik, edhe ndaj vetvetes. Tre emra të mëdhenj të letrave shqipe, që më pikëtakuan, sa me Shkodrën, sa me Atdheun letrar, ndryshe Atdheu e lirë nga diktatet "së jashtëmi", pra me vetveten si krijues dhe studiues, tri here radhazi, sa përmes medias së shkruar, sa përmes asaj elektronike, gjatë këtij "tetori" qenë:

Migjeni i madh, djali i shkodaloces, poeti dhe prozatori i përmasave evropiane dhe botërore, i dyti që Dritëroi, njëri nga poetët më njerëzorë të kësaj toke, dhëndërr Shkodre, ndryshe Uitmani shqiptar, liriku më i madh i ditëve tona, kurse i treti që personaliteti madhor, po aq kompleks i kulturës dhe letrave shqipe, tragjik, sa vetë fati i kombit të tij, pa të cilin, gjithsesi nuk mund të kuptohet Shkodra, Fishta, poeti ynë kombëtar, i dyti pas Naimit, ndryshe poeti më epik i shekullit që jetoj.

Që të tre "Nderi i Kombit". Ky i fundit, vërtet lindi në Lezhë, por gjithë frymëmarrja e tij, si veprim civil, letrar apo klerikal mori jetë, si askund tjetër në Shkodër, nderimin ndaj të cilit këtë tetor pata kënaqësinë ta përjetoja, jo në Shkodër, mjerisht, por, mjaft bukur, në vendlindjen e tij, në Lezhë, si i

veprimtarinë mbarëkombëtare "Festivali i mbarëkombëtar i poezisë me "motive migjeniane" që bëri Puka, më 8.10.2016, si i ftuar i kësaj veprimtarie dhe po aq si kritik letrar jam pronocuar kohë më parë, sikurse për Migjenin dhe Dritëroin jam pronocuar si i ftuar i Shkodra Tv-1, në ditëlindjen e tyre, kësaj radhe dua të jem sa më i plotë, në përpjekjen time, sa modeste, sa profesionale, për të përcjellë at akt fisnik, profesional, dhe të disiplinuar organizativisht, që Këshilli i Qarkut-Lezhë, nën drejtimin dhe po aq praninë fizike të kryetarit të tij, z. Gjokë Noka, organizoi më 21 tetor 2016, në mjediset e Pallatit të Kulturës të atij qyteti veprimtarinë kulturore në nderim të 145-vjetorit të lindjes së At' Gjergj Fishtës. Ja dekor i kësaj veprimtarie, ndryshe veshja "së jashtëmi" e saj: Ligjërata "Fishta në fishtologji" nga dr. Tonin Çobani, ku do të shpalosej vepra e poetit në studimet tona letrare të gjithkohshme, por edhe përmes zërit kritik, si pasurim dhe po aq si deversitet vizionesh, i autorit të këtij shkrimi, jo thjesht si demitizim i Fishtës, apo si pasqyrim sa më i plotë dhe korrekt i tipareve dalluese të korpusit fishtjan, por, po ashtu, edhe përmes paraqitjes së librit, me kritika letrare, "Troktë në livadhet e blerta", madje me vështrime kritike edhe ndaj katër krijuesve të qarkut Lezhë, të shkrimtarit Andrea Petrimilo, klubi letrar "Petro Marko" Vlorë, nga z. Azem Baliaj, nën moderimin e znj. Suela Bala, drejtore e bibliotekës së qytetit të Lezhës. Njëherish, sipas një planifikimi, paraprak, nga ana e organizatorëve, nën kujdesin profesional të poetit Viktor Gjokolaj, zëdhënës i këshillit të qarkut, do të intervistoheshin nga mediat e pranishme: shkrimtari dhe publicisti Sejdi Berisha, Pejë-Gjakovë, kryetari i jurisë së

tjane 30 poetë nga mbarë trojet shqiptare: Kosova, Maqedonia, Çamëria, Tirana, Durrësi, Tropoja, Vlora, Kukësi etj. Takimi poetik që u shpall nga "Mjeshtri Madh" Mirush Kabashi. Tërhoqën vëmendjen në këtë performancë artistike, me interpretimet e tyre, poetët: Gjon Marku, Brunilda Pervathi, Ndue Marku, Vladimir Muça, kantautori Gjon Frroku. U shquan gjithashtu interpretuesit e ansamblit "Mjeshtri i Madh", Gjergj Maku dhe Gjon Marku, me monografinë "Mirëdita në vite".

Përmasën artistike të këtij eventit kulturor e ridimensionoi edhe interpretimi i llojit të vet i "Mjeshtrit të Madh" Mirush Kabashi të një poezie nga Fishta. Nën drejtimin e dr. Sadik Bejkos, juria nderoi me certifikatën e çmimit letrar "Gjergj Fishta" pjesëmarrësit e këtij konkurimi artistik. Me përfundimin e veprimtarisë kulturore kushtuar përvjetorit të lindjes së poetit të madh, Gjergj Fishta, në nderim të miqve të ftuar nga trojet shqiptare dhe qytetet jashtë qarkut të Lezhës, këshilli i qarkut shtroi një darkë në mjediset e resortit turistik "Rafaelo-Shëngjin", me pronar biznesmenin e nderuar pukjan, z. Mark Gjini.

Kjo ishte Lezha e asaj dite, të atij përvjetorit fishtjan, 21 tetor 2016, një oaz poetik, ku mund të marrin shembull të shkëlqyer, civilizimi dhe moderacioni, të të ashtuquajturit metropole "me djep e pa djep" traditash kulturore. Kjo ishte Lezha e ditëve tona, me djep real, përkundjeje, vlerash poetike, dëshmi e një civilizimi, krejt origjinal, apel vlerësimi dhe integrimi vlerash të dinjitetit tonë kulturor kombëtar.

Kadri Ujkaj, kritik letrar

FALEMINDERIT KARDINAL ERNESTI!

(skicë)

La Morra është një qytezë-Komunë e vogël e Cuenos, në Italinë veriore. Ajo është e vendosur në një kodër 513 m mbi nivelin e detit. Kjo lartësi të krijon mundësinë për të parë një horizont mjaft të gjerë. Kur ngjitesh në këtë pikë, vija e horizontit zgjerohet mbi një territor shumë të gjerë, dhe shikon vetëm plantacione hardhishë dhe lajthishë, të mbjellura dhe të trajtuara me shumë kujdes, deri edhe nga ana estetike. Për vlerat që ka marrë ndër shekuj ky territor, UNESCO e ka marrë në mbrojtje. Në pikën më të lartë të kësaj kodre është vendosur një shtatore bronxi kushtuar të gjithë kultivuesëve të hardhive. Ajo shtatore është e kompozuar duke bashkëlidhur njeriun vreshtar dhe hardhinë në atë mënyrë sa pothuajse gjysma e shtatores është trung hardhie dhe pjesa tjetër trupi i një njeriu të thjeshtë që merret me kultivimin e hardhisë, me vegla pune të ngjeshura në mes.

Kjo qytezë është një vend turistik, prandaj ka vizitor për çdo ditë dhe në fundjavë fluksi i tyre shtohet shumë. E përshkrova me pak fjalë këtë qytezë, por qëllimi i kësaj skice është diku tjetër.

Në të dielën e 20 nëntorit, bashkë me vajzën time,



Norën, shkojmë në meshë në Kishën e Shën Martin, në La Morra. Është një kishë e ndërtuar në këtë kodër të bukur në vitet 1684-1695. Në meshë, prifti gjatë predikimeve të tij foli edhe për Ernest Troshanin, i cili para pak kohe u emrua, Kardinal nga Papa Françesku, por edhe i lumnuem bashkë me 37 martirë të tjerë të Shqipërisë, që dhanë jetën duke u vrarë, torturuar dhe gjetur vdekjen në burg nga regjimi komunist në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, vetëm se besonin në zot dhe mendonin ndryshe nga rrëgjimi i kohës.

Prifti foli për jetën dhe veprën e Kardinalit. U kup-

tova sa kisha mundësi se po përmendej emri i Shqipërisë dhe Kardinal Ernestit.

Kur mesha u krye, ime bijë më shpjegoi hollësisht në lidhje me çfarë tha prifti. Ai, më tha vajza, u shpjegoi besimtarëve të pranishëm se kush është kardinali i emruar nga Papa, dhe u dha edhe shumë hollë të tjera për Shqipërinë, ku është, madhësia e saj, popullsia dhe u ndalë veçanërisht në martirizimin e kishës katolike gjatë regjimit komunist.

Të them të drejtën, që kur kuptova se po flitej për Shqipërinë dhe Kardinal Ernestin, më pushtoi një ndenjë krenarie, por pas shpejtimeve të Norës, u ndjeva edhe më mirë, u ndjeva krenar për vendin tim që edhe në dhë të huaj, të bën të ngresh kokën lartë.

Faleminderit Kardinal Ernesti që më bëre të jem krenar edhe në dhë të huaj me punën dhe jetën tënde.

Faleminderit kardinal Ernesti,
Më bëre krenar në dhë të huaj,
Mu duk Shqipëria lart sa Everesti,
Kur prifti në La Morra lartësoj emrin Tuaj.

Luigj SHYTI


Frano Prendi, babai i prehistorisë shqiptare, zbuluesi i vendvarrimit të Gjergj Kastriotit

Pesë vjet më parë mbylli sytë përgjithmonë, në Bruksel të Belgjikës shkodrani Frano Prendi, një nder shkencëtarë me të rëndësishëm shqiptarë dhe pak i njohur në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër. Pata fatin të njihem me këtë figurë të madhe të arkeologjisë shqiptare ku me rrëfej jetën e tij imtime nga femëria e tij deri të arrijtjet shkencore.

Frano Prendi ka lindur me 27 gusht 1928, në Shkodër pranë shtëpisë së Loro Borçit, te shtëpia e Pogut, 200 metra në krahun e majtë, në rrugën "Badra". Ka mbaruar filloren dhe shkollën e shtetit te Dugajt e Reja. Më pas shkollën françeskane "Ilirikum" deri në klasën VI -të gjimnazit. E përjashtuan nga shkolla se ishte një nder drejtuesit e rinisë komuniste, pas përjashtimit pranohet në gjimnazin "29 Nëntori", ku ishte drejtor Mark Ndoja. Pas mbarimit të gjimnazit caktohet mësues në Reç të Malësisë së Madhe. Për një vitë ka shkuar në universitetin e Beogradit për histori-filozofi. Këtu njihet me pader Danjel Gjecaj. Ne Beograd ndërpret studimet për arsye të prishjeve të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë duke u transferuar në Sofje të Bullgarisë. Provimet e para i jepe në serbishte. Në Sofje përfundon shkëlqyeshëm studimet në vitin 1951, kur ishte 23 vjeç, i specializuar në Histori dhe Arkeologji.

Kthehet në atdhe dhe fillon punën në Muzeun Arkeologjik të Institutit të Shkencave në Tiranë, të krijuar në vitin 1946. Pas ndërhyrjes së profesor Aleks Buda specializohet për katër muaj, përsëri në Bullgari për arkologji. Në këtë kohë njihet me Maria Bonjoecha, me të cilën pati

dhe një vajze. Prishja e marrëdhënieve të shtetit shqiptar me Bullgarin, Maria që punonte në ambasadën Bullgare u detyrua të largohej nga Shqipëria dhe të prish martesën e saj. Kjo ishte drama e këtyre viteve për studentet shqiptarë që



kishin pasur partnere të huaja.

Në vitet e demokracisë, vajza erdhi dhe takoj babën e saj, Franon, e cila punonte si gazetare në radio Sofia.

Puna kërkimore e Prendit ishte një punë prej një kolosi dhe ai me të drejtë mund të quhet babai i prehistorisë shqiptare, thekson studiuesi i shquar Mikom Zeqo, ai që dokumentues i patjetërsueshëm, argumentues dhe përruesi i disiplinës shkencore, që nuk ekzistonte më parë. Vështirësitë nuk qëndronin vetëm në të panjohurën, por edhe në mungesën e një ekipi paraprak, ekip të cilin më vonë e përruroj dhe e bëri një fakt dhe aksion veprues tejet të suk-

sesshëm, kujton profesori, në kujtimet e tij, shkencëtari i madhe shqiptar.

Frano Prendi drejtoj punimet arkeologjike në të gjithë skajet e Shqipërisë. Ai, u bë një nga themeluesit e arkeologjisë shqiptare, së bashku me Hasan Ceken, Skender Anamali dhe Selim Islamin. Një meritë të madhe ka në studimin e qytetit Ilir të Lisit, në veçanti në zbulimin e vendvarrimit të Heroit tone Kombëtar, Gjergj Kastriotit.

Me iniciativën e pushtetit komuniste ishte "qarkullimi", që studiuesi i nderuar, dërgohet për të ndihmuar Lezhën si mësues Rusishteje, kujton profesor Prendi, kur iu vu detyrë nga komiteti i partisë të studioj për 500 vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit.

Nisa një pune tepër të vështirë duke studiuar të dhënat e Barletit, që kishte jetuar si prift në Shkodër, për të gjetur kishën e Shën Kollit në Lezhe. Pas një pune të madhe me literaturë dhe intervista me të moshuar, shkova tek pleqtë duke marrë të dhënat gojore, duke i krahasuar me burimet historike të relacioneve të Vatikanit, në, e shekullin e XV. Barleti kishte marrë pjesë në, e funeralin e Gjergj Kastriotit. Pas një pune voluminoze identifikon kishën e Shën Kollit, në atë kohë, në atë objekt flinte Hoxha me familjen e tij, që nuk kishte shtëpi. Pas ndërhyrjes së Komitetit Ekzekutive familja e Hoxhës stabilizohet me banesë të re. Fillova punën ku pashe menjëherë se ishte bërë një shtesë e re. Hapësira e xhamisë ishte mbi sipërfaqe, fotografava, vizatova dhe bëra skicimet, së bashku me studentet, që kishin ardhur nga Tirana. Sapo hoqa suvatimet, në altar u shfaqen

afareskat e Shën Kollit. Mora studiuesin Dhorka Llamba, studiues arti në institutin e monumenteve të kulturës, për të forcuar bindjet e pikturave. Arrita të vërtetoj se, kjo Kishë kthyer në xhami. Vendvarrimi ishte një varr Romak.

Erdhi komision, që u binde plotësisht, se ishte varri i Gjergj Kastriotit.

Kështu Kryetari i Akademisë së Shkencave, Aleks Buda më përgëzoi për punën e bërë. Vepra studimore e Prendit doli në dritë në vitin 2008, fale ndihmës financiare të arkeologut kosovar, e Shefki Gashi nga Prishtina dhe nen kujdesin e Profesor. As. Dr. Adem Bungullit, vepra u botua në Prishtinë. Ky botim pasqyron punën studimore të Prendit. Ky botim ka vlera të mëdha për studiuesit e rinj shqiptarë të fushës historike. Libri i kushtohet familjes së tij, gruas Drita, vajzave Mariana e Luciana, i cili kaloi ditët e fundit të jetës së tij, në Bruksel.

Pak kohe para ndarjes nga jeta i kisha premtuar mikut tim, që takohesha shpesh, se intervistën tënde do ta botoje në gazetën "Dukagjini".

Frano Prendi u nda nga jeta me 28 Dhjetor 2011, në Bruksel.

E di që miku im Frano Prendi meriton më shumë, i lënë në harrës nga koleget e tij për të shkruar për te, në 5 vjetorin e vdekjes.

Mendoj që vepra e tij do të frymëzoj historianët e rinj të Shkodrës dhe të vlerësohet siç i ka hije një shkencëtari.

I pa harruar kujtimi i tij!

Pushofsh ne Paqe!

Zef Nika,
Bruksel, Belgjikë

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi

SA E BUKUR ËSHTË JETA ...

Kam dëgjuar ta gjykojnë jetën
Kam dëgjuar të thonë...
Jetë e keqe, e fëlliqur, e vështirë...
Joooo, Jeta është e bukur...
Ajo nuk shuhet kurrë, ajo ka dy ditë.
SOT dhe NESER e përsëri vazhdon me,
SOT dhe NESER.....
Sot dua të ec, por nuk mundem.
Nesër do vrapoj dhe s' do kem kohe të ndaloj.
Sot dua të kujtoj të djeshmen,
por se kujtova dot
Nesër do shkruaj çfarë bëra sot
Sot fitova edhe një mike, që ndihmë më ofroi.
Nesër do ecim bashke mbi rrëzë e lagte.
Sot prita të takoj disa miq,
por disa të tjerë takova.
Nesër përsëri me miq do jem
dhe kjo ka rendësi.
Sot ... u sa pune i kam bërë sot
edhe pse nuk lëvizi dot.
Nesër punët e nisura do i përfundoj.
Sot dhoma nuk ja doli të më robëronte...
por imagjinata ime fluturoi.
Nesër përsëri qiellit do ja fal shikimin e pare.
E kush tha se JETA është e keqe?
Jeta është e bukur,
se ka vetëm SOT dhe NESER.
(Shkodër, më 7 gusht 2015)

ISH KOHA ATËHERË ...

Pa ... ish koha atëherë
Ku jeta në sfondin e kuq të saj
Kish gdhend një zemër të bardhë
Ku një cung pjeshke kish xanë rrajë
E me lulëzua nuk diti kurrë
Pa ..ish koha atëherë
ku hija e robit
+ Kallëzonte ma fort se fytyra e tij e zbehtë
Pa ...ish koha atëherë
Ku ëndrrat veniteshin
Pa t' zanë gjumi ende
Pa...ish koha atëherë
Ku dashuria vdiste
Pa i njom buzët puthja e parë
Pa ... ish koha atëherë
Ku plaga hapej
Për mos me vu dregëz asnjëherë
Pa ... ish koha atëherë
Ku u mboll fara
Që frytë s' ka me dhanë kurrë..
Pa ... ish koha atëherë
Ku udhëtuam me treni
E nuk dinim stacion ku me ndal
Pa ... ish koha atëherë.
E sot na kërkon me fal e me dashtë
Po, po me dashtë
Pa ... po a vështirë, se na u këput jeta
Bash ne puthjen e parë
E plaga dregëz s' vuri asnjëherë
(Shkodër, më 21 Tetor 2016)

MUZGU

Muzgu edhe sonte
Po puthet me qytetin temë
E prapë sonte rrugët po erren
Njerëz që dhanë çka ditën me dhanë
E prapë sonte i njëjte erdh muzgu
E prapë sonte ata që dhanë dashuri
Nuk panë se fara e dashurisë
S' po zë vendi e saj
E a e dini pseeeee.
Vëllai a bë ujk
E ujku a bë vëlla.
E muzgu prapë me më zë qokthi thotë
Harroje se
Vëllai ka shkon të rrëzo
E ka vjen të çon
Mësoje se
Ujku qimen e ndërron
E zakonin se harron
E tash muzgu e ka kohën
E nesër prapë në agim

Njerëzit e dritës kanë me dashtë.
(Shkodër, më 14 Tetor 2016)

KUR E NDJEJMË NE

Dritën kështu e njoh
Dhe natën po ashtu . . .
Ndjen dorën time akoma
Makar në errësirë . . .

Sa dielli më shkeli syrin
Andej bregut të lumit
Zhgreh rrezet pa kufi
Buzëqeshin malet pafund.

Rrugët i shkllasin njerëzit
Nëse dikë e kam për zemër
Vjen mungesa e jote
Me praninë e ëndrrave.

Ata që u tallën gjatë viteve
Në fshat po kthehen . . .
Njohin vendet e takimeve
Rrëfimet e para bëjnë histori.

Ku e ndjejnë edhe tani
Marramendjen e dashurisë . . .

DHURATË PËR NËNËN

Ardhja e marsit
Dritaret i hapi
Nëpër lëndina
Turret jeshilëlleku.

Një çapëkën i vogël
Mbledh lulet kodër në kodër
Dhuratë për nënën.

Beso atëherë
Shkëlqimin më të ri.

Troket majtas e djathtas
Tetë marsin . . .

Shtjellohet era e qeshur
Mot pas moti për nënat.

NGA PUTHJA HARLISËT JETA

Flokëverdha je ti
E gjithëpushtetshmja e syve . . .
Më e privilegjuar
Në kujtimet e vjetra.

E dashur
Nga përfaqimet e pafund
Rezonon pranvera . . .

Me puthje harlisët jeta
Dhe hapen "Oferta" ende.

Si shpjegohet aq mirë
Del në pah natyra
Jetojmë në pritje e takime.

Matanë dritares syri
Zhytet në jeshilëllëk
E lamë për këtë fund vjeshtë . . .

HAIKU

1
Terri i natës
Shkalafitet hap pas hapi
Bri më bri malit.

2
Veçmas për natën
Tata bëhet gati
Se lindi dielli . . .

3
Si e qysh në bjeshkë

Merr në shej lisat rrufeja
Natën e dimrit . . .

4
Veç xixëllonja
Në ballë të shkëmbit sonte
Terrin e lë pas.

5
Koha për rini
Nëpër hije lakuriq
Vetëm në prozhme.

6
Thjesht moj e dashur
Je ti gjër e gjatë
Në vend takime.

7
Ti për tangërllek
Te Kafja e Madhe ende
Sheh celularin . . .

8
Nëse ëndërron ti
Ku i del ama Drinit
Veroje bjeshkën.

9
Të shijon gjiri
Respekte Margarita
"Hasha ç'ka pashë".

10
Ndërkohë me shi
Njerëzit i lodh mërzia
Përballë motelit . . .

11
Dimri s'i përfill
Aspak rrezet e diellit
Larg atij akull

12
Shullahet réja
Majës Cukalit bëj bë
Ushtimë ahishtash.

13.
Unë e dielli
Tek ti në trandafille
Drekon pranvera . . .

14
Në zgrip të syrit
Paça bërë bë për ty
Nudo del në liqe.

poezi nga LAZËR PREKA

FLAMURI YNË

Larg në shekuj në histori
Përmes luftës burrërore
Yll Polar të patëm ty
Dhe do të kemi në çdo fitore.
Ke shqiponjën e Kastriotit
Kur të shpalosi në at Nëntor,
Pas errësirës qielli ndriti
Lum drite solle në Vlorë.
Je burim i përparimit
Të gjithë kombin e bashkon,
Nderi yt besa shqiptarit
Porsi Dielli kur agon.
O Flamuri Shqipërisë
Zemrat tona gëzon,
Të valvit flad i lirisë
Drejt progresit na frymëzon.

LULËKUQES

Jehona e betejave
Per ty, Atdhe
Kur vjen pranvera
Lajme sjell për ne.

Ngjyra kuq e zi
Re që gjëmon,
Dëshmorët për liri
Ti na i kujton.
Lulëkuqe e majit
Bukuri e radhë
Ajo pret djalin
Me dashuri e mall.
Në mes të gjelbërimit
Të ulur bisedojnë
Me ndjenjat e gëzimit
Lulëkuqet i rrethojnë.

GJERGJ KASTRIOTI

Gjëmon moti, ushton jehona
Vetëtimë drita shkëlqen,
Atje janë gdhendur shkronja
Lavdi thonë për këtë vend.

Nder, lavdi për Skënderbeun
Për Heroin tonë Kombëtar,
Burr i madh i këtij dheu
Krenari për çdo shqiptar.

Nuk e di, Nanë e Madhe
A mund të flas për birin tand,
A do të di ta gjej fjalën
Me tan shpirtin që unë kam.

Ishte Ora e Shqipërisë
Shqiponjë e Zanës së malit,
Që nga koha e Arbërisë
I ndriçon rrugën shqiptarit.

Në rrebesh, në zjarr e flakë
Shpata e tij rrufe nxorri,
Ndal i tha "Portës së Lartë"
Dhe fitore në luftë korri.

"Lirinë nuk e solla unë
Për të gjithë është lapidar,
Ky pishtar nuk shuhet kurrë
Në zemër e ka çdo shqiptar."

Të gjithë arbërit luftëtar
Shpërnda ishin nëpër shkrepë,
Si kalorësit legjendar
Mbi armiqt hidhnin shigjeta.

Vajza të bukura porsi drita
Çdo ditë kuvendonin bashkë,
Ato kujtonin kohët e shkuara
Trimat e renë, lavdinë e lashtë.

Erdh një zë nga historia
Dhe na solli amanetin,
Është e shtrenjt për ne liria
Edhe besa e Kastriotit.

LUIGJ GURAKUQIT

Në Kuvend u çue një burrë
Që i dha lajmin Shqipërisë:
"Që sot me këtë flamur
Thyem prangat e robërisë."

Nga të gjithë u bë një be:
"Shqipëria është e jona,
Për liri dhe për atdhe
Flakë i bëjmë zemrat tona."

Ballë per ballë atje në Krajli
Fjala e jote peshoi rendë,
Ju kërkua vetëm liri
Pa zaptues, pa tiranë.

Gurakuq të kemi pranë
Në çdo zemër ke një vend,
Që kudo anë e mbanë
Dritë i jep kombit tend.

poezi nga Luigj Temali

Arilena Ara, një Zanë e Këngës Magjike

Arilena Ara, vajza e Luigj e Mira Ara, nga lagja Boks, fshati Gjuraj, krahinë e Pultit, por e lindur dhe e rritur në qytetin e Shkodrës, tashme është një këngëtare shumë e njohur. Prinderit e saj, të mrekullueshëm, kanë arritur të daltojnë në formimin e saj dashurin për jetën dhe artin. Kujtojmë këtu përfaqimin, që Arilena i bëri babit të saj, të ndjerit Luigj, në momentin kur ajo u shpall fituese, tek Gjeniu i vogël. Një përfaqimi Falënderimi për babin, i cili sakrifikoji shumë ta sjellte deri tek fitorja. Ai vazhdon të kundroj nga qielli suksesin e vajzës së tij, Arilënës.

Arilena Ara ka marrë pjesë në shumë festivale për fëmijë në Shkodër. Si fillim u prezantua në "Gjeniu i Vogël" dhe më pas ajo vendosi të konkurronte në X Factor Albania. Kjo ishte dëshira e babait të saj, i cili u nda nga jeta pak muaj para se Arilena të prezantohej në X Factor 2. Arilena fitoi kompeticionin, duke i dedikuar fitoren babait të saj.

Një vit pas fitores në X Factor, Arilena kthehet në skenën e të njëjtit spektakël,



në finalen e X Factor 3 për të prom-

ovuar këngën e saj të parë me titullin "Aeroplan". Shumë njerëz pyesnin, se ku përfundoi Arilena pas mbarimit të "X-Factor", çfarë po bën menjëherë i ri për të dhe kur do vi në skenë. "Se unë vi si Aeroplan", ishte përgjigja, që Arilena i dha opinionit në një moment delikat të karrierës së saj dhe kënga u kthye në një tërmet, e cila dominoi në radiot dhe televizionet muzikore. Kënga "Aeroplan" mbeti për 6 javë në 3 vendet e para të hiteve të ndryshme.

Arilena, pohon se ka ndryshuar pas sukseseve të arritura në muzikë. Dikur ishte një konkurrençe që afrohej e ndrojtur në kompeticionet muzikore, ndërsa tani ka kaluar në një stad tjetër. Tani që është në botën e artit si protagoniste, mendon dhe kujdeset për emrin e saj, kujdeset për veshjet dhe ka ndryshuar

mënyra e saj e të menduarit.

Kjo u vërtetua më së miri, në Këngën Magjike 2016, ku me këngën "Nëntori", me producent Darko Dimetro dhe tekst Lindon Berisha. Suksesi pritej pasi të gjitha komponentët përbërëse të Këngës ishin të realizuar me mjeshtri. Arilena është fituese e çmimit 'Best Balade'. Në marrjen e çmimit solli një rengjethje shpirtrash, kur titullin ja dedikoj Ergi Dinit, që u nda nga jeta aksidentalisht së bashku me shokun e tij Klejdi Halilin. Një gjest shumë humanë, që ja rritet vlerat Arilënës si artiste dhe si njeri.

Arilena tashmë fuqishëm e ka hedhur hapin e sigurt në Maratonën e sukseseve. Faleminderit Arilena!

Roza Pjetri

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

